

20251012238

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË PËRDORIMIT TË GJUHËS MAQEDONASE

Neni 1

Në Ligjin e Përdorimit të Gjuhës Maqedonase (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” numër 21/24 dhe 14/25), në nenin 22, në paragrafin (1) fjalët: “me cilësinë e personit juridik” shlyhen.

Paragrafi (2) shlyhet.

Paragrafi (3) bëhet paragraf (2).

Neni 2

Pas nenit 22, shtohet nen i ri 22-a si në vijim:

“Neni 22-a

(1) Me punën e Inspektoratit udhëheq drejtor.

(2) Drejtorin e Inspektoratit e emëron dhe shkarkon Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Për emërimin e drejtorit të Inspektoratit Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut shpall konkurs publik në të paktën tre gazeta ditore, të cilat publikohen në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga të cilat njëra prej gazetave që botohet në gjuhë të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare, të ndryshme nga gjuha maqedonase.

(4) Drejtori i Inspektoratit ka mandat katërvjeçar dhe mund të riemërohet vetëm edhe një mandat tjetër.”.

Neni 3

Në nenin 23, pika 5) ndryshohet si vijon:

“posedon vërtetim, certifikatë ose dokument tjetër për dhënien e provimit për njohjen e njërës prej katër gjuhëve më të përdorura të Bashkimit Europian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht dhe italisht) në nivelin B2 të Kornizës Europiane të Referencës për Gjuhët, të lëshuar nga një institucion në shtet ose jashtë vendit, të regjistruar si ofrues i këtij shërbimi dhe;”.

Neni 4

Neni 24 ndryshohet si vijon:

“Drejtori kompetencat e veta i kryen në pajtime me nenin 30 të Ligjit të Mbikëqyrjes Inspektuese.”.

Neni 5

Pas nenit 24 shtohet nen i ri 24-a si në vijim:

“Neni 24-a

(1) Mandati i Drejtorit të Inspektoratit përfundon me kërkesën e tij personale, pra me dorëheqje të parashtruar me shkrim dhe me forcën e ligjit në një nga këto raste:

- nëse atij i ka ndodhur paaftësi e përhershme ose e përkohshme për ushtrimin pa pengesa të funksionit të tij më shumë se gjashtë muaj ose ndërron jetë dhe

- nëse plotëson kushtet për ushtrimin e të drejtës i pensionit të pleqërisë.

(2) Drejtori i Inspektoratit mund të shkarkohet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, para skadimit të mandatit për të cilin është emëruar, në një nga rastet e mëposhtme:

- nëse nuk punon dhe nuk vepron sipas këtij ligji dhe ligji tjetër dhe aktet e Inspektoratit dhe

- nëse me punën e vet të pa ndërgjegjshme dhe të pa rregullt, shkakton ndërprerje në kryerjen e punës së Inspektoratit dhe shkakton dëme.

(3) Nëse skadon mandati i drejtorit ose është shkarkuar para kohe, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut do të emërojë ushtrues detyre drejtor.

(4) Ushtruesi i detyrës drejtor ka mandat deri në emërimin e drejtorit të ri të Inspektoratit, por jo më shumë se tre muaj.”.

Neni 6

Neni 26 shlyhet.

Neni 7

(1) Ministria e Kulturës dhe Turizmit, në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Ligji, është e detyruar të harmonizojë aktet për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit me dispozitat e këtij Ligji.

(2) Inspektorati i Përdorimit të Gjuhës Standarde Maqedonase, pas harmonizimit të akteve për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit me dispozitat e këtij Ligji, do të fillojë punën e tij si organ në kuadër të Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit.

Neni 8

Drejtori i Inspektoratit të Përdorimit të Gjuhës Standarde Maqedonase i emëruar deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të vazhdojë të ushtrojë funksionin deri në skadimin e mandatit për të cilin është emëruar.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.